



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 18.

Prishtinë, më 15.05.2015, në ora 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Rustem Mustafa, Valdete Bajrami, Luljeta Veselaj- Gutaj dhe Ilir Deda.

Munguan : Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Slobodan Petroviq dhe Kujtim Paçaku. .

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve;

Kryetarja Teuta Sahatqija theksoi se ky Projektligj ka qenë edhe me herët në Komision për shqyrtim, por për shkak të mangësive është kthyer në Qeveri për ripunim.

Tani na ka ardhur projektligji i ripunuar dhe duhet kaluar sepse është në kuadrin e pakos së ligjeve për liberalizimin e vizave. Vërejtjet tona që i kemi dhënë tani janë përfshirë dhe në komision duhet të dalim me rekomandim për miratim në parim.

Në vazhdim ajo pyeti anëtarët se a kanë vërejtje dhe sugjerime dhe lidhur me këtë e hapi debatin.

Ilir Deda vlerësoi se projektligji i ardhur tani është i mirë dhe i avancuar dhe me standarde më të larta ndërkombëtare. Në vazhdim ai tha se kishte vetëm një vërejtje të afati kohor prej 12 muajve për shkatërrimin e të dhënave. Ky afat tha, duhet të shkurtohet dhe të jetë 3 ose 6 muaj.

Luljeta Gutaj-Veseli theksoi se për dallim nga Projektligji i kaluar, të cilin e patëm kthyer për ripunim ka ndryshime dhe janë marrë parasysh rekomandimet dhe është ligj i definuar mirë... Pajtohet me propozimin e z. Ilir Deda se afati prej 12 muajve për shkatërrimin e të dhënave është i gjatë. Ky Projektligj duhet të kalojë sepse është i rëndësishëm për liberalizimin e vizave.

Time Kadrijaj tha se në krahasim me projektligjin e mëparshëm, ky projektligj është më i avancuar, ku janë qartësuar detyrat dhe përgjegjësia e personave përgjegjës.

Valdete Bajrami tha se është për tu përshëndetur ky përmirësim total i projektligjit . Është shtytje për lexim të parë dhe në përgjithësi është i kompletuar.

Rrustem Mustafa ishte i kënaqur me projektligjin, por pati vërejtje të përgjithshme sepse siç tha, po përsëriten gjërat. Ato duhet të thuhet më shkurt dhe më saktë. Janë disa fjalë të panevojshme, të cilat së bashku do ti përmirësojmë.

Teuta Sahatqija, kryetare, tha se po shihet se kemi konsensus të plotë për Projektligjin për Përgjime, për t'ia rekomanduar Kuvendit për miratim. Pasi është me procedurë të shpejtë, propozoj që nga e hëna të fillohet me grupin e punës, i cili do të jetë në përbërje prej 5 ose 6 vetash. Propozoj që Ilir Deda të jetë kryetar i grupit të punës dhe anëtarë të jenë deputetët që ishin prezent në mbledhje, por edhe ata që nuk morën pjesë në mbledhje mund të marrin pjesë. Grupi i punës duhet të shqyrtoj Projektligjin dhe në takim duhet të ftohen përfaqësuesit nga Ministria e Integrimeve, prokuroria, policia, shoqëria civile, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj.

Pas dy takimeve grupi i punës duhet t'i paraqes në komision amendamentet për miratim dhe pastaj ti dorëzohet raporti me rekomandime Kuvendit për lexim të dytë.

Teuta Sahatqija, kryetare, pas diskutimeve konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji për Përgjimin e Telekomunikimeve.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Teuta Sahatqija
